



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

**SHPALLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:
SPECIALIST BURIME NJERËZORE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:

Emërtesa e pozicionit: Specialist për Burimet Njerëzore

Klasa e pagës: IV-2

Drejtoria: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Raporton te: Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT: Specialisti i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse (burime njerëzore) përgjigjet te Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse për sigurimin e respektimit të kuadrit ligjor që rregullon marrëdhëniet e punës mbi rekrutimin, trajnimin dhe monitorimin e performancës në punë të punonjësve të Agjencisë.

3. DETYRAT KRYESORE:

- Administron Regjistrin Themeltar të punonjësve, sipas legjislacionit në fuqi (sistemi HRMIS);
- Harton, ndjek dhe zbaton kontratat me punonjësit e Agjencisë;
- Plotëson dosjet personale të punonjësve të Agjencisë, sipas kërkesave të vendosura në aktet e brendshme të Agjencisë dhe ato me vendime të tjera;
- Realizon procesin e rekrutimit në punë, sipas kuadrit ligjor në fuqi;
- Menaxhon sistemin e aksesit për hyrje daljet në Institucionit, nga punonjësit.
- Përpilon dhe ndjek hartimin e listëprezencave mujore, ndjek në sistemin e-albania të depozitimit të raporteve mjekësore, ndjek realizimin e lejeve vjetore dhe planifikimin e tyre.
- Ndjek procedurat për punonjësit që janë me lejelindje.
- Ndjek plotësimin e vlerësimeve të punës dhe harton regjistrin e nevojave për trajnime nga stafi.

4. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDITATI

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës.

5. KËRKESAT E POSAÇME:

Arsimi minimal: Bachelor në shkenca ekonomike/juridike. Diplomati, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Të ketë paktën 1 (një) vit eksperiencë pune.

Tjetër: Dije të përgjithshme të parimeve, koncepteve, metodave dhe teknikave të profesionit, të mjaftueshme për të realizuar detyrat e pozicionit. Aftësi për të përzgjedhur informacionin e nevojshëm ose materiale referuese të nevojshme, për të realizuar detyra që lidhen me fushën përkatëse të njohurive; aftësi shumë të mira organizative.

6. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar;
- b - Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet

pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim, dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës: **(11.10.2023 afati i fundit i aplikimit)**

7. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT

Në vijim, AIDA do të realizojë:

1- Fazën e parë të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore;

a- nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim.

b- nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;

2 - Faza e dytë e konkurrimit është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni. Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

8. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen. Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditor nga përfundimi i vlerësimit.